

BASHKËIA POGRADEC

NR. 2439

ROT

DAT 03.06.2020

Pogradec më \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /2020

KESHILLI

KËRKESË PËR INICIATIVË QYTETARE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

POGRADEC

**TË NDERUAR ZONJA/ZOTËRINJ KËSHILLTARË!**

Në cilësinë e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit në qytetin e Pogradecit, duke konsideruar se jemi jemi pjesa më e madhe e kategorisë që përfaqësojmë në mbështetje të nenit 20, pika 1 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ju parashtrojmë një kërkesë tonën e cila besojmë se do të ketë mbështetjen tuaj për tu kthyer në vendimmarrje dhe e detyrueshme për të gjithë.

Konkretisht, propozojmë për vendimmarrje **Shpalljen e ditës së djelë, ditë pushimi për gjithë aktivitetet e tregëtimit të mallrave, industrialë, Ushqimore, shërbime, mish peshk bulmet.** Nga ky rregull propozojmë të bëjnë përjashtim, pra të qëndrojnë të hapura edhe ditë të djelë vetëm kategoritë bar-kafe, restorantet, fast food-et, pra kryesisht aktivitetet e nevojshme për lodhje dhe turizëm. Detajime të mëtejshme të kategorive mundet të parashikohen nga ana juaj.

Qëllimi i këtij propozimi është kryesisht përmirësimi i cilësisë së jetësës së tregëtarëve dhe të punësuarve në këtë sektor pasi momentalisht punohet 7 ditë në javë dhe në shumë raste me orare të zgjatura përtej 8 orarshit. Jemi të bindur se vendosja e një dite pushimi për këto subjekte do të ndikojë pozitivisht për sejcilin nga tregëtarët e këtyre kategorive dhe nga ana tjetër nuk do të ketë pasoja financiare në dëm të tyre duke konsideruar se konsumi i familjeve është i njëjtë, do ndryshojë vetëm forma e blerjes nga 7 ditë në javë në 6 ditë në javë në të njëjtën sasi blerjesh në total. Ky fakt u provua më së miri gjatë periudhës së karantinimit për shkak të pandemisë, ku për një periudhë rreth 2 mujore, aktiviteti tregëtim Ushqimore, nuk zhvillonte aktivitet ditët e djela.


Mendojmë se është momenti që të fillojmë ta zbatojmë këtë masë për cdo javë për aktivitete e sipërpërmenduar. Kjo kërkesë sot përkrahet nga të gjitha bizneset dhe banorët, por shqetësimi i vetëm i tregëtarëve është që kjo të jetë e sanksionuar nëpërmjet vendimmarrjes tuaj, madje dhe me masa sanksionuese për bizneset që nuk e respektojnë, në mënyrë që të mos ketë pakënaqësira apo lëvizje të klientëve të bizneseve nga një dyqan tek tjetri.


Për këtë qëllim bashkangjitur po ju paraqesim listën totale të mbështetësve të kësaj inisiativë në formën e një peticioni.

Besojmë se do të gjejmë mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj duke miratuar një Urdhëresë e cila të parashikojë ditën e djelë si ditë pushimi për kategoritë e bizneseve të mësipërme me sanksionet përkatëse për ata që nuk e zbatojnë këtë urdhëresë.

Me respekt!

**Nga grupi nismëtar:**

Blerina Spohu  Tel: 069 93 83 577.

Shqipëri  Tel: 069 2212 192.